

STATUT

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“PRO COMMUNICATION” sh.p.k.

Kreu 1

Themelimi, emri, objekti dhe selia.

Neni 1

Themelimi

- 1- Sot me datë 30.09.2024 unë themeluesi Roland Agron Sulaj kam krijuar një shoqëri tregtare me emrin “ PRO COMMUNICATION” sh.p.k.
- 2- Themeluesi I shoqërisë është ortaku I vetëm :
 - Roland Agron Sulaj nr ID : J20509107S

Neni 2

Objekti

Shoqëria do kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

1- Shërbime të ndryshme marketingu si :

- a. Organizim eventesh te ndryshme, seminare, konferenca, workshope, panairë inaugurime festa te ndryshme etj, Perkttime me shkrim dhe me goje, konsektiv, simultan etj. Marrje dhe dhenie me qera paisje audio vizuale, sisteme perkthimi, sisteme audio, led wall etj, sherbime fotografike, printime, kancelari, hostes, bashkepunime me hotele dhe struktura te

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqërisë është **1,000,000 lekë**. Nga I cili :

| | |
|---|------------------|
| Mjete monetare Arke | 100,000 |
| Inventarë në mallra dhe produkte të gatshme | 200,000 |
| Makineri, vegla dhe pajisje pune | 700,000 |
| TOTALI | 1,000,000 |

Pjesëmarrja e themeluesve të shoqërisë është në kontributet e tyre më poshtme :

- Ortaku themelues Roland Sulaj zotërues I një kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :

- 1- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- 2- Shitblerjes
- 3- Trashëgimisë
- 4- Dhurimit
- 5- Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

1. Ndryshimet e statutit
2. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
3. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
4. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat më lart b dhe c
5. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
7. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
8. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
9. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
10. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
11. Miratimin e rregullave proceduriale për mbledhjen e asamblesë
12. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo shteti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose një person i tretë.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme



Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës e tu dërgohet jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të kuotave, janë të pranishëm personalisht , votojnë me shkresë apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart , asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.



Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit, për ndryshimin në statut, zvogelimin apo zmadhimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve dhe riorganizimin e shoqërisë apo prishjen e saj.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- 1- Përcaktimi i politikave të shoqërisë;
- 2- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- 3- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 4- Përcaktimin e shpërblimeve
- 5- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 6- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- 7- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përrjashtimi nga e drejta votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për :

- 1) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - 2) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - 3) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - 4) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku që përfaqëson.

Neni 13

Administrimi


1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme :



Të dhënat e identifikimit

dhe specimenët e nënshkrimit

(mbiemri, emri, adresa) :

Roland Sulaj 

1- SULAJ Roland, rruga "Ura e Limuthit", Kashar, Tirane.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të :

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjet e fitimeve l paraqesin këto dokumente për miratim te asambleja e përgjithshme.
5. Krijojnë një system paralejmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme, siç parashikohet në ligjin e QKB;
7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshmenë lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare.
8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
9. Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:



- 1) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiarerezulton se ekziston rreziku që Aktivet e shoqërisë nuk i mblojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- 2) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve totale të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
- 3) Shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozoi të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve totale të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
- 4) Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një Administrator ata e administrojnë bashkërishtë shoqërinë.

10. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e Administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërise.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit ose ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballur në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administrator detyrohet :



- 1- Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
 1. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 2. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 3. Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të intereseva personalë me ata të shoqërisë;
 4. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm;
- 2- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 3- Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta që kanë përfituar nga kryerja e veprimeve të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator ato përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 4- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen veprimet e mëposhtme :
 1. U kthen ortakëve kontributet;
 2. U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 3. I shpërndan aktivet e shoqërisë



4. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjëndje financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
5. Jep kredi.
6. Përveç se për shlyerjen e dëmit që l ngarkohet personalisht Administratorit , ortakëtn individualisht ose së bashku kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundrejt Administratorit.
7. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që l është shkaktuar shoqërisë, përfshirë dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim l asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër Administratorit, për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar – ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar l shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti l parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një të tillë l ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël l autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultetit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është l detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi l shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. Me vendim të Asamblisë së Ortakëve

3. Me hapjen e procedurave të falimentimit
4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
5. Me vendim gjykate;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve në Përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të ligjit 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe të gjithave ligjeve tjera të shtetit.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PRO COMMUNICATION" sh.p.k.

Roland Sulaj

